



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1250 Prot.

Tiranë, më 12.09 2017

VENDIM Nr. 185, datë 05.09.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.11, datë 05.09.2017 pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Shtesë objektesh në projektin "GREEN COAST RESORT" Palasë, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë*" -subjekti "GREEN COAST" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "K.A.E.XH." sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Shtesë objektesh në projektin "GREEN COAST RESORT" Palasë, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë*" -subjekti "GREEN COAST" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "K.A.E.XH." sh.p.k
2. Të vijojnë punimet e ndërtimit sipas akt-marrëveshje tre palëshe të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të KKA Nr. 62, datë 08.06.2016 për projektin "GREEN COAST RESORT" Palasë, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTRI



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO